Kronikë

# Sherr për vendin e parkimit në Lezhë, plagoset me armë zjarri shoferi i furgonit të Laçit! U qëllua me 3 plumba në këmbë! Në kërkim autori (EMRAT)

*Tonin Ndreca është qëlluar me 3 plumba në këmbë ndërsa autori, me të cilin dyshohet se është konflikturar është larguar nga vendi i ngjarjes dhe policia ka nisur kërkimet për arrestimin e tij*

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Qëndrimi

Elvis Hila
25 Nëntor, 10:59 | Përditësuar: 25 Nëntor, 12:10

Share

A A

**LEZHË**- Një konflikt i çastit mes dy personave për vendin e parkimit në Lezhë përfundoi me të shtëna me armë zjarri dhe plagosjen e njërit prej tyre. Ngjarja ndodhi rreth orës 11:00 të së shtunës në rrugën e 'Shtrausit', në afërsi të Urës së Cenit, ndërsa i plagosur mbeti Tonin Ndreca 35-vjeç shofer furgoni banues në Laç.

Ai u qëllua me tre plumba pistolete në pjesën e këmbëve dhe u dërgua me urgjencë për ndihmë mjekësore në Spitalin Rajonal të Lezhës, nga ku mësohet se ndodhet nën kujdesin e bluzave të bardha jashtë rrezikut për jetën.

Sh.com

LEXO EDHE:
**Fjerin Ndreu-Berishës: Boll o shpifësirë se nuk pushove së nxjerrur bale nga goja! Spiun i sigurimit, qenia më e neveritshme e këtij vendi**

Ndërkohë policia e cila mbërriti menjëherë në vendin e ngjarjes arriti të identifikoj dhe shpalli në kërkim autorin e dyshuar të plagosjes. Ai është shtetasi Marjan Kola banues në Laç, i cili u largua me shpejtësi me automjet pas ngjarjes. Forca të shumta policie janë vënë në ndjekje të tij, por pa arritur ende të neutralizojnë dhe vënë në pranga.

Nga veprimet paraprake hetimore bëhet me dije se ngjarja ka ndodhur pas një konflikti të çastit për parkimin e automjeteve mes autorit dhe të plagosur.

Fillimisht ata janë përplasur fizikisht me njëri tjetrin e më pas Marjan Kola, ka njëmë armen që mbante me vete dhe qëlluar në drejtim të 35-vjeçarit Tonin Ndreca i cili bëhte me furgon linjën Laç-Lezhë.

Në cilësinë e provës materiale u gjeten dhe sekuestruan 3 gëzhoja, ndërsa janë shoqërëruar dhe po merren në pyetje disa persona për të zbardhur plotësisht rrethanat e ngjarjes.

Rendit zhvillimet sipas orarit Të Fundit

Ora 12:10
## Plagosja për vendin e parkimit në Lezhë, kush është autori që qëlloi në drejtim të 35-vjeçarit

Marjan Kola është autori i cili plagosi me armë zjarri 35-vjeçarin Tonin Ndreca. Ai është shpallur në kërkim nga policia, ndërsa konflikti me tyre ndodhi për shkak të sherrit për vendin e parkimit.

M.Q./Shqiptarja.com

Share

Ora 11:42
## Sherr për parkimin e makinave, kush është 35-vjeçari që mbeti i plagosur

Tonin Ndreca, shofer i furgonit të Laçit, ka mbetur i plagosur nga të shtëna me armë zjarri paraditen e sotme në Lezhë. Sipas policisë shkak për konfliktin mes 35-vjeçarit dhe shtetasit M.K, është bërë vendi i parkimit.

> *Rreth orës 11.00, në qytet Lezhë, në afërsi të shinave të trenit, gjatë një konflikt të çastit që dyshohet për parkimin e automjeteve, shtetasi M. K. banues në Kurbin, ka plagosur me armë zjarri shtetasin T. N. 35 vjeç, banues në Laç, i cili ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën.*
>
> *Autori i dyshuar është larguar menjëherë pas ngjarjes dhe vijon ndjekja nga ana e shërbimeve të Policisë për lokalizimin dhe kapjen e tij.*
>
> *Në vendngjarje, grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë, po kryen veprimet hetimore për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes dhe dokumentimin ligjor.\- njofton policia.*

M.Q./Shqiptarja.com

Share

Ora 11:39
## Detaje të reja nga plagosja në Lezhë/ Shoferi u qëllua me tre plumba në të dyja këmbët

Detaje të reja nga plagosja në Lezhë.

Report Tv mëson se drejtuesi i furgonit, Tonin Ndreca, vjeç, banues në Laç ka marrë tre plumba në të dyja këmbët dhe është dërguar në spitalin e Lezhës ndërsa autori është larguar.

Në vendngjarje është gjetur edhe një kaçavidë që mendohet se me të mund të ketë tentuar të goditet edhe personi që ka qëlluar më pas me armë në drejtim të drejtuesit të furgonit por nuk dihen rrethanat se si ka nisur debati.

S.G./Shqiptarja.com

Share

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: Marjan Kola | Lezhë | Tonin Ndreca | Ki

Komentoj

Komente

Alb: 25/11/2023 16:50
Kjo asnjë sigurija ne shqipërin, por nje debate te ik jeta
Pëngëgëgë

Or tej: 25/11/2023 23:55
Edhe ne londer i zaptojkemi parkingjet me hurj, hekura, karrike dhe parataj po ju parku kush dhin me kallasha or teee@@

gezim: 25/11/2023 18:03
ndodh dhe ne londer sheni. Më besoni se Shqipëria nuk është më e pasigurtë dhe e vetmja gjë që mungon në Shqipëri është drejtësia

Ndalohet riprodhimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016.

SH

Sondazhi i ditës:
Besoni se vota e emigrantëve do realizohet në zgjedhjet e 2025-ës?

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera

Moti i keq, disa zona pa energji elektrike në Lezhë
25 Nëntor, 19:18

Festa e Nëntorit/ Me çifteli e qeleshe, të veglët përcjellin traditën në Lezhë! Në Vlorë cicerone në Muzeun e Pavarësisë
25 Nëntor, 16:51

Ritja e veprave penale me autor të mitur, institucionet ligjzbatuese në Lezhë marrëveshje koordinimi
Elvis Hila
22 Nëntor, 13:53

Varfëri dhe sëmundje, jeta në mjerim e familjes Markaj në Shullaz të Kurbinit! Kryefamiljari i pa punë, grusja merr pension invaliditeti vetëm 625 lekë në muaj
Elvis Hila
27 Nëntor, 16:46

Aksident në rrugën Lezhë-Shkodër, përplasen 3 automjetet! Njëri prej të plagosurve i bllokuar në makinë e mbajnë me serum
Elvis Hila
27 Nëntor, 15:19

Lezhë/ U bllokuan 4 vite më parë! Sipërmarrësit kërkojnë të ndërtojnë hotele në Shëngjin! I kërkojnë qeverisë të zhblokojë lejet e ndërtimit
Elvis Hila
20 Nëntor, 17:28

Lezhë/ Mbante kallashnikov pa leje në banesë, arrestohet 41-vjeçari! Sekuestrohen 10 kg kanabis në kuadër të operacionit 'Tempulli'
20 Nëntor, 14:10

SPAK kërkon 4 vjet burg për ish kryetarin e bashkisë së Lezhës, Fran Frrokaj dhe konfiskimin e tokës me vlerë 13 mln euro tek 'Rana e Hedhun'
20 Nëntor, 13:36

Shkrumbohet nga zjarri makina në Fushë-Mamurras! Automjeti ishte në lëvizje, babe e bir shpëtojnë pa lëndime
19 Nëntor, 14:51

Vrasja dhe qoposja e 16-vjeçarit në Kurbin, dosje penale kalon për gjykim! Kristian Çenaj do përballet me akuzën 'vjedhje me pasojë vdekjen'
Elvis Hila
19 Nëntor, 09:11

Mirdërë/ Përkujtohet 100-vjetori i shkollës së parë në Selitë, 'gjepi' shekullor i dijes u hap mes maleve nga Dom Vlash Muça
Elvis Hila
18 Nëntor, 16:51

Lezhë/ Mësuesi qoditi nxënësin në shkollën 'Kosova', pezullohet nga punë! Klasa e 9-të në protestë: Nuk futemi në mësim pa profesorin, ra pre e një kurthi
Elvis Hila
16 Nëntor, 09:47



© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pauatorizuar i kësaj faqeje